



**Reflektime dhe mësim të nxjerra nga zbatimi i qasjes  
ndërdisiplinore, ndërsektoriale dhe restauruese në  
menaxhimin e rasteve të të miturve**

*Zbatuar në rrethet gjyqësore Shkodër dhe Pukë*

Tiranë, Gusht 2022

Ky botim u përgatit në kuadër të projektit “Forcimi i qasjeve ndërdisiplinore në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt dhe kontakt me ligjin”, i zbatuar nga konsorciumi i organizatave Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, (QZHK) si pjesë e Programit “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore” të UNICEF Shqipëri, me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e organizatave partnere dhe nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë si opinion i UNICEF dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

\*\*\*

Përgatitja e botimit u drejtua nga Prof.Asoc.Dr. Brunilda Zenelaga.

Në përgatitjen e tij kontribuoi grupi i punës nga organizatat partnere të përfshirë në ideimin, mbarëvajtjen dhe zbatimin e projektit, pjesë e të cilit është dhe përgatitja e këtij botimi, respektivisht, Z. Rasim Gjoka, Znj. Fabiola Laço Egro, Znj. Merita Bala, Znj. Mirela Tahiraj, Znj. Andja Trasja, Znj. Vjola Cikalleshi dhe Znj. Manjola Stefani.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e qasjes ndërinstytucionale dhe ndërdisiplinore kanë dhënë koordinatorët dhe ekspertët lokalë, Znj. Ervina Shaba, Znj. Antigona Rexha, Z. Anton Koca, Znj. Griselda Dama, Z. Leonard Hila, Znj. Vinifrenda Gazulli, Z. Altin Nika, Z. Ilirjan Lleshi, Znj. Aretenisa Çoku; drejtuesit e stafi i bashkive përkatëse në Shkodër dhe Pukë, partnerë kryesorë të projektit, si dhe institucionet e tjera në nivel lokal të përfshirë në administrimin e drejtësisë për të mitur.

Ndërhyrja është realizuar me mbështetjen dhe konsulencën nga UNICEF.

\*\*\*

**Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”**

Adresa: Rruga "Him Kollit", Pallati P.F.Trade, Nr.5, Tiranë

Web: <https://www.mediationalb.org/>

E-mail: [mediation@afcr.al](mailto:mediation@afcr.al)

Tel: 0695663077

**Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”**

Rruga e Elbasanit. Pallati Abau. Sh.2, K.6, Ap.13, Tiranë

Web: <https://www.cdc-tff.org/>

Email: [info@cdc-tff.org](mailto:info@cdc-tff.org)

Tel: 052907010; 0694094622

# Përmbajtja

1. Hyrje.....	Fq. 4
2. Profili i organizatave të konsorciumit zbatues.....	Fq. 6
3. Përmbledhje ekzekutive e projektit.....	Fq. 7
3.1. Qasja ndërsektorale dhe ndërdisiplinore për trajtimin e fëmijëve në konflikt/ kontakt me ligjin ose dhe në situatë risku.....	Fq. 7
3.2. Përmbledhje e rezultateve kryesore të projektit.....	Fq. 8
4. Aspekte metodologjike të vlerësimit .....	Fq. 9
5. Konkluzione të zbatimit të qasjes ndërdisiplinore për të miturit në konflikt, kontakt me ligjin dhe atyre të riskuar.....	Fq. 14
5.1. Konkluzione nga seancat trajnuese me aktorët që merren me të miturit në konflikt /kontakt me ligjin dhe atyre të riskuar.....	Fq. 14
5.2. Konkluzione nga programet e ndërhyrjes dypalëshe prind-fëmijë.....	Fq. 18
5.3. Konkluzione nga testet para dhe pas veprimtarive argëtuese me të rinjtë.....	Fq. 19
5.4. Konkluzione nga takimet trajnuese dhe workshopet me nxënësit në lidhje me komponentin e zgjidhjes së konflikteve.....	Fq. 20
5.5. Refleksione nga intervista me profesionistë, ofrues shërbimesh për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin.....	Fq. 21
5.6. Këndvështrime nga përfituesit.....	Fq. 26
6. Histori suksesi.....	Fq. 28
7. Sfidat të identifikuara nga zbatuesit e projektit.....	Fq. 31
8. Sugjerime për vazhdimësinë e zbatimit të qasjes ndërdisiplinore për të miturit në konflikt e kontakt me ligjin ose në situatë rreziku.....	Fq. 33
9. Burime të përdorura.....	Fq. 34
9. Shtojca.....	Fq. 35

## 1. HYRJE

Ky libërth elektronik paraqet disa mësim të nxjerra nga zbatimi i projektit “Forcimi i qasjeve ndërdisiplinore në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt dhe kontakt me ligjin”, i zbatuar nga Konsorciumi i organizatave Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, si pjesë e Programit “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore” të UNICEF Shqipëri, me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Përgjatë këtij projekti, sikurse ishte planifikuar, u mundësuan disa ndërhyrje si: menaxhim i integruar i rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin nëpërmjet qasjeve ndërdisiplinore dhe ndërinstitucionale; shmangia nga procedura penale; ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; ofrimi i shërbimeve juridike, psikologjike, social-ekonomike për të miturit në konflikt dhe kontakt me ligjin ose dhe në situata risku, ofrimi i seancave të prindërimit pozitiv dhe i veprimtarive me karakter argëtues dhe artistik për të rinjtë, workshope me fokus në zgjidhjen e konflikteve për nxënësit etj. Ofrimi i këtyre shërbimeve ka si synim integrimin dhe riintegrimin e të miturve në jetën normale dhe largimin e tyre nga devijanca dhe delikuenca.

Libërthi shërben si një reflektim i realizuar përgjatë një rrugëtimi njëmbëdhjetë mujor, kohë në të cilën u zbatua projekti i sipërpërmendur dhe ka si synim të pasqyrojë reflektime nga profesionistë të përfshirë në menaxhimin e rasteve të të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin si dhe të atyre në situata risku, sipas një qasjeje ndërdisiplinore; perceptime të vetë të miturve dhe prindërve që përfituan nga këta shërbime, si dhe refleksione të aktorëve që zbatuan këtë projekt.

Gjithashtu ky libërth pasqyron praktikën pozitive në menaxhimin e integruar të rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin ose në situatë risku, duke evidentuar mësimet e nxjerra gjatë procesit zbatues të aktiviteteve të projektit.

Kështu, libërthi u shërben të gjithë aktorëve të sipërpërmendur dhe përbën një kontribut për të kuptuar dinamikën e ofrimit të shërbimeve ndërdisiplinore për të miturit në konflikt dhe kontakt me ligjin, sfidat me të cilat përballë ky proces, si dhe mënyrat për kapërcimin e tyre.

Për të pasur të qartë disa nga këto ndërhyrje, është e rëndësishme të jepet një sqarim për disa koncepte që do të përdoren në këtë libërth, referuar Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

**Shmangie** është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.

**Masë e drejtësisë restauruese** është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një veprë penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri

që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një veprë penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

**Ndërmjetësimi** është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

**Mentorimi** është një proces komunikimi, këshillimi dhe orientimi i fëmijëve nga ana e mentorit, që përmes prezantimit të përvojave të reja dhe ndarjes së vlerave pozitive, i ndihmon ata të shmangin sjelljet devijante, të mënjanojë situatat konfliktuese, duke ndikuar kështu pozitivisht në sjelljet dhe integrimin e tyre.

## 2. PROFILI I ORGANIZATAVE TË KONSORCIUMIT ZBATUES



### **Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi Mosmarrëveshjeve" (FZKPM)**

FZKPM është një organizatë profesionale e shoqërisë civile me një përvojë 27-vjeçare në fushën e promovimit dhe zbatimit të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve/ndërmjetësimit në Shqipëri. Ndërhyrjet e FZKPM-së përfshijnë lobimin dhe kontributin në draftimin e bazës ligjore të ndërmjetësimit, si dhe në fusha të tjera, p.sh. kontributin në përfshirjen e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur; rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve institucionalë të sistemit të drejtësisë, ato ligjzbatuese dhe shërbimofruese, etj., si dhe publikut më gjerë për zgjidhjen e konflikteve përmes formave alternative/ndërmjetësimit; rritjen e kapaciteteve në fushën e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese si për profesionistët dhe për ndërmjetësit; ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit në fushën civile, tregtare, familjare e penale. Programet pilote, si ato të ndërmjetësimit të lidhur me gjykatën, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës për të miturit, kanë shërbyer për krijimin e modeleve të suksesshme dhe për advokimin për një shtrirje më të gjerë dhe institucionalizimin e tyre. Një komponent i rëndësishëm është dhe ai i zgjidhjes së konflikteve në mënyrë paqësore në mjediset shkollore përmes dialogut restaurues, ndërmjetësimit të moshatarëve, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, etj. Dhjetëra botime, si revista sociolo-juridike-kulturore, gazeta, libra, manuale, studime etj., janë përgatitur ndër vite, duke kontribuar si në rritjen e ndërgjegjësimit, ashtu dhe të kapaciteteve në fushën e ndërmjetësimit, negocimit, drejtësisë restauruese, etj.



### **Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"**

QZHK "Sot për të Ardhmen" është një organizatë lider në Shqipëri për mobilizimin dhe fuqizimin e komuniteteve të marginalizuara. E udhëhequr nga vizioni dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, "Sot për të Ardhmen" ka krijuar qasje ndërdisiplinore në funksion të komunitetit dhe grupeve të veçanta, duke qenë një organizatë me bazë komunitare dhe me prioritet barazinë gjinore, gratë, fëmijët dhe familjet, të cilat konsiderohen si target-grupe prioritare në ndërhyrjet për fuqizimin e komuniteteve. Organizata është ofruese e shërbimeve për fëmijët dhe advokon për të drejtat, mbrojtjen dhe fuqizimin e tyre nëpërmjet a) shërbimeve të drejtpërdrejta si: mbështetje dhe këshillim psiko-social dhe ligjor, masa parandaluese për viktimat e mundshme, shërbime të integritit e ri-integritit, si dhe shërbime të orientimit, fuqizimit dhe ndërmjetësimit si dhe b) nëpërmjet ndërgjegjësimit, avokimit, lobimit dhe rritjes për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve dhe për qasje për përmirësimin dhe forcimin e kornizave përkatëse në nivel qendror dhe lokal.

### **3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PROJEKTIT**

#### **3.1. Qasja ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore për trajtimin e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin ose dhe në situatë risku**

E veçanta e projektit në procesin zbatues në Shkodër dhe në Pukë kishte të bënte me të konceptuarit e bashkëpunimit, disi të munguar, ndërmjet institucioneve që kanë rol në procesin e administrimit të drejtësisë për të mitur si: Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki, të Prokurorisë, Gjyqësorit, Shërbimit të Provës, Policisë, si dhe të institucioneve të tjera të përcaktuar në ligj për t'u kujdesur për fëmijët dhe të miturit në veçanti, gjithnjë në funksion të zbatimit të drejtësisë miqësore për fëmijët. Megjithëse ka përcaktime të qarta në legjislacion rreth rolit të secilit prej institucioneve në këtë proces, në praktikë është konstatuar moskoordinim dhe mosbashkërendim për të adresuar problematikat, me të cilat ballafaqohen veçanërisht të miturit në konflikt/ kontakt me ligjin.

Për këtë qëllim u parashikuan dhe u zhvilluan aktivitete të përbashkëta si: workshope trajnuese dhe ndërgjegjësuere, ku krahas informacionit dhe praktikave të trajtimit të të miturve, bazuar në legjislacionin e miratuar, institucionet të mund të bashkëpunonin dhe bashkërendoheshin ndërmjet tyre, në shkëmbim informacioni, komunikim dhe ajo që është më e rëndësishmja, në dhënien në kohë të asistencës së kërkuar, duke nisur nga vlerësimi i rasteve, shmangies nga procedura penale, aplikimin e masave alternative dhe veçanërisht të masës së shmangies në programe restauruese dhe të ndërmjetësimit viktimë- kundërvajtës apo takimeve në grup. Aktiviteti informues dhe ndërgjegjësuere u shoqërua me zhvillim të takimeve të përbashkëta të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN-së), me pjesëmarrjen e aktorëve të parashikuar në legjislacion, duke bërë të mundur vlerësimin në kohë të rasteve dhe bërjen funksionale të mekanizimit të referimit të miturve në konflikt/kontakt me ligjin në programe të ndihmës ligjore, konsulencës psikologjike, sociale dhe ekonomike dhe të drejtësisë restauruese, në bërjen me solide të bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërinstitutional. Me mbështetjen dhe bashkëpunimin e UNICEF u bë e mundur të draftohet Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe të pranohet e nënshkruhet nga të gjitha institucionet vendore dhe qendrore, që kanë përgjegjësi dhe rol për të luajtur në fushën e drejtësisë miqësore për të miturit. E veçanta e formalizimit të këtij bashkëpunimi ishte dhe marrja e rolit drejtues nga ana e bashkive përkatëse në gjithë procesin e arritjes së bashkëpunimit, me mbështetjen e UNICEF dhe të organizatave zbatuese, gjë e cila krijon kushtet për mundësinë e vazhdimit të këtij bashkëpunimi edhe pas përfundimit të programit.

Qasja e shërbimeve të integruara ndërdisiplinore ishte në qendër të vëmendjes gjatë zbatimit të projektit nga ana e partnerëve. Kjo u konkretizua me harmonizimin e bashkëpunimit dhe partneritetit, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit, në shërbimet përkatëse si: shërbimin e ndihmës juridike, të shërbimeve në fushën e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese, vlerësimit dhe këshillimit psikologjik, asistencës sociale dhe ekonomike, mentorimit dhe prindërimit pozitiv.

Procesi referues nga ana e institucioneve përkatëse të miturve në situatë konflikti ose dhe risku është shoqëruar me një rivlerësim të llojeve të shërbimeve rast pas rasti nga ana e ekspertëve, duke mundësuar që në shumicën e rasteve të ketë një integrim të shërbimeve si p.sh.: ndihmë juridike dhe shërbim psikologjik për të miturit, ose mentorim dhe shërbime sociale dhe ekonomike, etj. Në këtë drejtim rol parësor ka luajtur grupi i ekspertëve të përzgjedhur, të cilët me profesionalizmin e treguar, dhanë një shembull të mirë se si mund të punohet së bashku, duke shkëmbyer informacione për rastet dhe duke dhënë sugjerime për shërbime plotësuese për të miturit.

### 3.2. Përmbledhje e rezultateve kryesore të projektit

Më poshtë janë dhënë në mënyrë të përmbledhur rezultatet kryesore të projektit:

- **76** profesionistë nga institucionet lokale të drejtësisë, zbatimit të ligjit dhe ato shërbimofruese, që trajtojnë raste të fëmijëve në kontakt/konflikt dhe situatë risku rritën kapacitetet e tyre në fushën e drejtësisë miqësore për fëmijët, zbatimit të qasjeve restauruese, masave alternative, shmangies, ndërmjetësimit dhe formave të tjera të drejtësisë restauruese dhe dimensionit të barazisë gjinore.
- **32** takime individuale dhe ndërsektoriale të organizuara, në nivel menaxhues dhe teknik, me qëllim forcimin e mekanizmit të referimit dhe trajtimit ndërsektorial të rasteve të të miturve, nga të cilat:
  - o 8 takime me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve lokalë të administrimit të drejtësisë për të miturit;
  - o 24 takime individuale me përfaqësues të institucioneve.
- **149 raste** të referuara nga institucionet për t'u trajtuar përmes qasjes ndërdisiplinore, duke përfshirë shërbime të ndihmës ligjore, shërbim psikologjik, pako ushqimore, paketa me mjete profesionale etj.
- **28 raste të** trajtuara të përmes praktikave restauruese.
- **39 fëmijë** dhe të rinj të përfshirë në programe mentorimi, ri-integrimi.
- **362** fëmijë e të rinj dhe disa prindër të përfshirë në aktivitete rikrijuese. **15 nxënës** nga shkolla e mesme "Sabah Sinani", Pukë, të përfshirë në vënie në skenë të minidramës "Besmir", dhe **20 nxënës** të përfshirë në realizimin e murales me tematikë "Drejtësia është miqësore me ty".
- **95** prindër të informuar dhe ndërgjegjësuar për prindërimin pozitiv.
- **182** nxënës, mësues, psikologë, punonjës sigurie, drejtues shkollash, të përfshirë në programin e zgjidhjes së konflikteve përmes dialogut restaurues, ndërmjetësimit dhe rrethit të paqes, duke e promovuar këtë model dhe në Ditën e Drejtësisë për të Mitur në Shkodër, ku morën pjesë **72** pjesëmarrës, përfaqësues nga institucionet lokale, komuniteti i prindërve, nxënës e mësues.
- **111** pjesëmarrës (74 prindër dhe 37 fëmijë) të informuar dhe ndërgjegjësuar për të drejtat e fëmijëve në proceset penale, masat alternative dhe drejtësinë restauruese.
- **2** Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe pjesëmarrëse në administrimin e drejtësisë penale për të mitur për koordinimin e veprimtarisë për drejtësinë miqësore ndaj fëmijës në nivel vendor, të arritura respektivisht në Shkodër dhe Pukë.



#### 4. ASPEKTE METODOLOGJIKE TË VLERËSIMIT

Duke synuar pasqyrimin sa më objektiv të përvojës së krijuar përgjatë zbatimit të projektit, u përdor një qasje metodologjike e shumëfishtë, duke shqyrtuar të dhëna të përfuara nga burime të ndryshme, përgjatë zbatimit të projektit.

Së pari, përgjatë disa veprimtarive me aktorë që punojnë me të mitur në konflikt dhe kontakt me ligjin, u përdorën dy linja për mbledhjen e të dhënave: së pari, teste para dhe pas veprimtarisë; së dyti, mbledhje e ideve të paraqitura gjatë diskutimeve mes profesionistëve.

Kështu, përgjatë 2 seminareve trajnuese një ditore në lidhje me masat alternative dhe drejtësinë restauruese, të zhvilluara në Shkodër dhe në Pukë në datat 2 dhjetor 2021 në Shkodër dhe 3 dhjetor 2021 në Pukë, u plotësuan nga pjesëmarrësit teste para dhe pas aktivitetit për të matur nivelin e të kuptuarit dhe ndryshimin e njohurive të tyre për temat e ofruara. Në seminarët trajnuese një ditore morën pjesë specialistë të mbrojtjes së fëmijëve nga bashkitë përkatëse, oficerë policie, specialistë të shërbimit të provës, përfaqësues nga prokuroria (koordinatorë/psikologë) si dhe specialistë nga zyrat e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit (43 pjesëmarrës - 23 në Shkodër dhe 20 në Pukë).

Gjithashtu teste u zhvilluan edhe para dhe pas seminareve të trajnimeve 2-ditore që u mbajtën në Shkodër dhe Pukë, përkatësisht në datat 2-3 shkurt 2022 dhe 8-9 shkurt 2022, me pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të 56 profesionistëve (përkatësisht, 26/Shkodër dhe 30/Pukë) nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, policia, prokuroria, shërbimi i provës, arsimit, shëndetësia dhe shërbimet e punësimit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Përgjatë këtyre veprimtarive, u mbajtën shënime nga diskutimet e zhvilluara (në formën e një fokus-grupi), të cilat gjithashtu shërbyen si instrument për mbledhjen e të dhënave cilësore në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij libërthi.

Së treti, u realizuan intervista të drejtpërdrejta gjysmë të strukturuar me profesionistë në sektorë të ndryshëm të shërbimeve psiko-sociale, juridike dhe të punësimit, që u ofrohen të miturve në konflikt ose në kontakt me ligjin si dhe atyre në risk për të qenë të tillë, si dhe intervista me koordinatore lokale të përfshirë në projekt. Gjithsej u realizuan 11 intervista të thelluara me profesionistë që në punën e tyre kanë në fokus edhe të mitur në konflikt/kontakt me ligjin. Intervistat u realizuan përgjatë një periudhe 8 mujore. 6 nga të intervistuarit ishin femra dhe 5 meshkuj. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur përbërjen e kampionit që mori pjesë në intervistim.

<b>Profesioni</b>	<b>Shkodër</b>	<b>Pukë</b>
Psikolog/e	3	1
Avokat/e – jurist/e	1	1
Specialist/e në programet e punësimit		1
Koordinator/e lokale	1	
Oficer/e policie		1
Përfaqësues i Shërbimit të Provës		1
Mësues/e	1	
<b>Shuma</b>	<b>6</b>	<b>5</b>

Tabela 1. Të dhëna të kampionit të profesionistëve të intervistuar

Të intervistuarit përfaqësonin institucione të ndryshme, që kanë në fokus të tyre, përveç të tjerash, edhe të mitur në konflikt/kontakt me ligjin si: sektori i shërbimit social në bashki, komisariate të policisë, prokurori, klinika ligjore, zyra arsimore etj. Përmes intervistave u hulumtuan më në thellësi problematikat me të cilat ballafaqohen profesionistët përgjatë zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit (KDPM) dhe veçanërisht përgjatë ofrimit të shërbimeve juridike, psikologjike, ekonomike, të ndërmjetësimit etj. Një qëllim tjetër i intervistimit kishte të bënte me eksplorimin e përvojës pozitive në ofrimin e shërbimeve dhe aplikimin e drejtësisë/qasjeve restauruese për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin, si dhe në evidentimin, sipas opinioneve të të intervistuarve, të përvojës së fituar pas tre vitesh të hyrjes në zbatim të KDPM. Në këtë proces u synua të evidentohej se çfarë funksion mirë dhe çfarë konsiderohet sfidë, si dhe të merreshin sugjerime për përmirësime në fushën e legjislacionit penal për të miturit dhe veçanërisht të praktikës zbatuese të këtij legjislacioni.

Së katërti, një komponent i rëndësishëm i këtij projekti ka të bëjë me programet e ndërhyrjes dypalëshe prind-fëmijë. Pjesëmarrja e prindërve në këto programe është siguruar nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme: 1) Organizimi i një sërë seminaresh dhe takimesh/telefonatash vijuese me prindër mbi prindërimin pozitiv/disiplinimin pozitiv; 2) Aktivitete edukative dhe rekreative ndërgjegjësuese me fëmijët; dhe 3) Sesione informative për aktivitete ndërgjegjësuese për qasjet e reja të drejtësisë penale. Si pjesë e serisë së seminareve dhe takimeve/telefonatave vijuese me prindër mbi prindërimin pozitiv/disiplinimin pozitiv, me lente të barazisë gjinore, “Marrëdhëniet e shëndetshme familjare” u zhvilluan 4 seminare/workshope përgjatë periudhës 20 dhjetor 2021- 23 mars 2022 të cilat u zhvilluan: 1 në Pukë, 2 në Shkodër dhe 1 në Fushë -Arrëz, në të cilat morën pjesë gjithsej 95 prindër por edhe të rinj. Para dhe pas këtyre trajnimeve/workshopeve u zhvilluan teste, rezultatet e të cilave janë paraqitur në këtë libërth.

Së pesti, vlen të përmendet se një tjetër element metodologjik lidhet edhe me shqyrtimin e perceptimeve të të rinjve që morën pjesë në aktivitete sensibilizuese dhe argëtuese në kuadrin e këtij projekti. Janë zhvilluar gjithsej 8 aktivitete të tilla, ku janë angazhuar 38 fëmijë dhe të rinj. Gjatë muajit mars 2022, të rinjtë e qeverisë së nxënësve dhe aktivistë të gjimnazit "Sabah Sinani" Pukë së bashku me mentorin e artit kanë krijuar një grup prej 15 vetash, nga të rinjtë e mbështetur përmes projektit, duke vepruar si aktorë/artistë dhe kanë punuar shumë për vënien në skenë të minidramës me titull "Besmir". 20 të rinj, aktivistë dhe artistë të talentuar të këtij gjimnazi, në kuadër të Drejtësisë Miqësore për Fëmijë realizuan muralen "Drejtësia është miqësore me ty". Me të rinj, pjesëmarrës në këto aktivitete u zhvilluan teste para dhe pas këtyre veprimtarive, rezultatet e të cilave paraqiten në seksionin e konkuzioneve të këtij libërthi.

Së gjashti, pjesë e vlerësimit të projektit ishte dhe komponenti i zgjidhjes së konflikteve në shkolla përmes ndërmjetësimit dhe dialogut restaurues, i shtrirë në disa shkolla 9-vjeçare dhe të mesme të Shkodrës dhe Pukës. Në workshopet me fokus menaxhimin e konflikteve në mjediset shkollore përmes ndërmjetësimit midis bashkëmoshatarëve dhe praktikave restauruese, të organizuara me pjesëmarrjen e nxënësve, por edhe psikologëve, mësuesve dhe drejtues të shkollave u evidentua një prirje në rritje e angazhimin e pjesëmarrësve për të diskutuar rreth llojeve të situatave konfliktuese në mjediset e shkollave, të shkaqeve të konflikteve, të rolit të aktorëve të shkollës, si të mësuesve, psikologut, oficerit të sigurisë dhe qeverisë së nxënësve në evidentimin dhe zgjidhjen paqësore të situatave konfliktuese. Me interes u ndoqën prezantimet e bëra nga ekspertët për dialogun restaurues dhe rrethin e paqes si instrumente për trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara nga situatat e krijuara. Element i aktiviteteve për zgjidhje konfliktesh në shkolla ishte dhe vlerësimi i ndryshimeve në procesin e të kuptuarit dhe perceptimit të 182 nxënësve rreth disa pyetjeve për kuptimin mbi konfliktin dhe situatën konfliktuese, trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve në mjediset shkollore, kuptimit rreth shmangies, etj.

Së shtati, biseda të lira të drejtpërdrejta u realizuan edhe me të mitur dhe të rinj përfitues nga programet e këshillimit dhe mentorimit dhe shërbime të tjera, të ofruara në kuadër të qasjes ndërdisiplinore në projektin e sipërpërmendur. Gjithsej u përfshinë në biseda të lira 4 të mitur përfitues, nga të cilët 3 në Shkodër dhe 1 në Pukë, 2 vajza dhe 2 djem. Procesi i bisedimit u realizua në praninë e një psikologu, mentori, prindi ose kujdestari ligjor. Përgjatë bisedave me të miturit u tregua kujdes i veçantë që të përdorej një gjuhë miqësore me ta, në përputhje me zhvillimin e tyre moshor.

Së teti, u eksplorua në mënyrë të thelluar edhe rasti i dy të miturve në konflikt me ligjin, një në Shkodër e një në Pukë, duke evidentuar suksesin e ofrimit të shërbimeve sipas një qasjeje ndërdisiplinore.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur të dhëna sasiore në lidhje me kampionin pjesëmarrës në procesin e zbatimit të testeve para dhe pas aktiviteteve, të diskutimeve të

grup (fokus-grupe) përgjatë seancave trajnuese, intervistimit të profesionistëve dhe bisedave të lira me të mitur përfitues.

Aparati metodologjik	Numri i pjesëmarrësve		
	Shkodër	Pukë	Fushë Arrëz
Diskutime në grup dhe teste para dhe pas seancave një ditore të trajnimit të profesionistëve	23	20	-
Diskutime në grup dhe teste para dhe pas seminareve trajnuese dy ditore të profesionistëve	26	30	-
Diskutime në grup dhe teste para dhe pas workshopeve të prindërimit pozitiv	40	30	22
Teste para dhe pas aktiviteteve argëtuese me të rinj		38	-
Teste para dhe pas workshopeve me nxënës për komponentin e zgjidhjes së konflikteve	132	50	-
Intervista të thelluara me profesionistë	6	5	-
Biseda të lira me përfitues	3	1	-
Analiza e dy rasteve studimore	1	1	-

Tabela 2. Përmbledhje e pjesëmarrësve në diskutimet në grup, në testet para dhe pas seancave trajnuese, në intervistat e drejtpërdrejta dhe biseda të lira me të mitur

Së nënti, u shqyrtuan raportet periodike të hartuara nga organizatat zbatuese në kuadër të projektit. Të dhënat e përfuara nga raportet përçojnë përvojën e këtyre organizatave përgjatë rrugëtimit të projektit.

Gjithashtu u realizuan në mënyrë të vazhdueshme biseda të lira me punonjës së këtyre organizatave, për të hedhur dritë mbi sfidat me të cilat ata u përballën përgjatë zbatimit të qasjes ndërdisiplinore të menaxhimit të rasteve të të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin.

Në mënyrë të përmbledhur ky aparat metodologjik është paraqitur në tabelën e mëposhtme:




Figura 1. Skema metodologjike e mblledhjes së të dhënave

## **5. KONKLUZIONE TË ZBATIMIT TË QASJES NDËRDISIPLINORE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT, KONTAKT ME LIGJIN DHE ATYRE TË RISKUAR**

### **5.1. Konkluzione nga seancat trajnuese me aktorët që merren me të miturit në konflikt /kontakt me ligjin dhe atyre të riskuar**

Me qëllimin për të matur nivelin e të kuptuarit dhe ndryshimin e njohurive të pjesëmarrësve për temat e ofruara, instrumenti i testeve paraprahe dhe atyre pas seancave trajnuese u përdor si në seminarët trajnuese një ditore në lidhje me masat alternative dhe drejtësinë restauruese për të miturit në konflikt e kontakt me ligjin, të zhvilluara në Shkodër dhe në Pukë në dhjetor të vitit 2021, ashtu edhe në trajnimet dyditore që u mbajtën në Shkodër dhe Pukë në shkurt të vitit 2022.

Nga të dhënat e përpunuara të testeve paraprahe dhe atyre pas seancave trajnuese të zhvilluara në dhjetor, në Shkodër dhe Pukë, rezultoi se pas sesioneve 91.25% e pjesëmarrësve demonstuan një kuptim të duhur të shmangies, masave alternative, drejtësisë restauruese dhe modeleve të saj dhe ndryshim të nivelit të njohurive lidhur me to.

Niveli i ndryshimit u vu re në disa elementë:

- ✓ Edhe pse në testet paraprahe të gjithë pjesëmarrësit deklaruan se kishin informacion për shmangien, vetëm 41% e tyre iu përgjigjën pyetjes së hapur: “Nëse po, çfarë është devijimi nga ndjekja penale”. Në testet pas trajnimit niveli i përgjigjeve për këtë pyetje të hapur ishte 94%. Pra, ka një ndryshim pozitiv të njohurive me 53%.
- ✓ Nga testet pas trajnimit u vu re se njohuritë për masat alternative për të miturit në konflikt me ligjin janë rritur me 78% (89% janë përgjigjur saktë në testet pas trajnimit, krahasuar me 11% në testet paraprahe).
- ✓ Për sa i përket kuptimit të drejtësisë restauruese, vihet re se, pavarësisht se në testet paraprahe, 100% e pjesëmarrësve deklaruan se kanë informacion për Drejtësinë Restauruese, vetëm 32% e përshkruan kuptimin e saj dhe vetëm 12% ishin në gjendje të përmendnin modelet e Drejtësisë Restauruese të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Në testet pas trajnimit, 92% e pjesëmarrësve përshkruan kuptimin e duhur të Drejtësisë Restauruese dhe 90% përmendën modelet e saj. Niveli i ndryshimit vlerësohet të jetë 60% për konceptin e Drejtësisë Restauruese dhe 78% për modelet e Drejtësisë Restauruese.

Në mënyrë të përmblëdhur rezultatet paraqiten në tabelën 3.

Çështja	Para seancave trajnuese	Pas seancave trajnuese	Niveli i ndryshimit
Informacion i saktë për shmangien	41%	94%	53%
Njohuritë për masat alternative për të miturit në konflikt me ligjin	11%	89%	78%
Kuptimi i saktë për Drejtësinë Restauruese	32%	92%	60%
Dhënia e modeleve për Drejtësinë Restauruese	12%	90%	78%

Tabela 3. Niveli i ndryshimit të njohurive nga testet para dhe pas seancave një ditore të trajnimit në Shkodër dhe Pukë në dhjetor 2021

Teste paraprake, si dhe ato përfundimtare, u përdorën edhe në seancat trajnuese dyditore me temë: “Drejtësia miqësore për fëmijët: Menaxhimi ndërdisiplinor i rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin”, të zhvilluara në shkurt 2022 në Shkodër dhe Pukë.

Rezultatet e këtyre testeve mund të përmblidhen në tri çështje kryesore. Ato nxorën në pah se:

- ✓ Afro 54% e pjesëmarrësve demonstuan pas trajnimit një përmirësim të konceptit të Drejtësisë Miqësore për fëmijët;
- ✓ Rreth 35% demonstuan një përmirësim të njohurive të tyre për masat e parashikuara në Kodin Penal të Drejtësisë për të Miturit, lidhur me Drejtësinë Restauruese, si një instrument i rëndësishëm i drejtësisë miqësore për fëmijët;
- ✓ Rreth 47% e profesionistëve që kanë marrë pjesë në trajnimet e Shkodrës dhe Pukës kanë përmirësuar njohuritë e tyre për menaxhimin ndërdisiplinor të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e analizës para dhe pas seancave trajnuese paraqiten si më poshtë në tabelën nr. 4.

<b>Çështja</b>	<b>Para seancave trajnuese</b>	<b>Pas seancave trajnuese</b>	<b>Niveli i ndryshimit</b>
<b>Kuptim i duhur të konceptit të Drejtësisë Miqësore për fëmijët</b>	43%	97%	54%
<b>Njohuri për masat e parashikuara në Kodin Penal të Drejtësisë për të Miturit, lidhur me Drejtësinë Restauruese, si një instrument i rëndësishëm i Drejtësisë Miqësore për Fëmijët</b>	54%	89%	35%
<b>Njohuri tyre për menaxhimin ndërdisiplinor të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin.</b>	47%	94%	47%

Tabela 4. Niveli i ndryshimit të njohurive nga testet para dhe pas trajnimeve dy ditore në Shkodër dhe Pukë në shkurt 2021

Të dhënat e mësipërme dëshmojnë për efikasitetin e seancave të trajnimit, sidomos kur pjesëmarrësit përfaqësojnë qasje ndërdisiplinore të ndryshme dhe plotësojnë tablonë e ofrimit të shërbimeve për të miturit në konflikt dhe kontakt me ligjin, si dhe ata në risk për të qenë të tillë.

Sikurse u përmend edhe më sipër, përveç të dhënave të përfuara nga testet para dhe pas seancave trajnuese, u gjeneruan ide edhe nga diskutimet në grup mes përfaqësuesve të institucioneve që ofrojnë shërbime të ndryshme në lidhje me kategorinë e të miturve në konflikt/kontakt me ligjin si dhe atyre në risk. Pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me aspektet pozitive të programeve të shmangies dhe restaurimit, siç janë:

- Trajtimi i kujdesshëm dhe jondëshkues i të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin dhe ofrimi i një mundësie të dytë;
- Ulja e nivelit të ngarkesës në institucionet që zbatojnë drejtësinë penale;
- Rritja e frymës bashkëpunuese mes institucioneve në funksion të rehabilitimit dhe riintegritimit të fëmijëve në kontakt dhe konflikt me ligjin;
- Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin dhe familjeve të tyre;
- Forcimi i rolit të edukimit në modelimin e sjelljeve të fëmijëve;
- Ulja e nivelit të recidivizmit (përsëritjes së kundërvajtjeve ose veprave penale);
- Parandalimi i sjelljeve devijante të të miturve në situata risku;
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë për rëndësinë e punës së koordinuar në funksion të përmirësimit të jetës së fëmijëve.



Gjithashtu përgjatë diskutimeve pjesëmarrësit evidentuan gjithashtu sfidat me të cilat përballen përgjatë përpjekjeve për të zbatuar këto programe, siç janë:

- Nevoja për një koordinim më të mirë të institucioneve të nivelit vendor (për shembull shkëmbimi i informacionit ndërmjet prokurorisë dhe autoriteteve arsimore dhe anasjelltas; përmirësimi i planifikimit dhe vendimmarrjes ndërinstitucionale, e cila përbën një përparësi).
- Referimi dhe ofrimi i shërbimeve, në funksion të masave parandaluese, garancive procedurale, masave mbrojtëse/drejtësisë dhe mbështetjes për riintegrim.
- Buxhetimi i shërbimeve të ofruara për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin nga institucionet e ndryshme, mungesa e të cilit shpesh shkaktohet edhe nga mungesa e bazës ligjore për buxhetimin. Pjesëmarrësit përmendën se transporti për profesionistët që ofrojnë shërbimet atje ku të miturit jetojnë, por edhe baza materiale që vihet në dispozicion fëmijëve dhe prindërve të tyre, mbulohet nga vetë profesionistët me vullnetin e tyre të mirë.
- Ndjekja e rastit të të miturit nga institucionet në mënyrë të integruar. Pavarësisht se ekziston një sistem që pasqyron një bazë të dhënash për të miturit në konflikt me ligjin, i ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe ku kanë akses dhe Zyra e Shërbimeve Sociale dhe Komisariati i Policisë, sistemi nuk lejon të ndiqet ecuria e rastit dhe shpesh profesionistët nuk kanë dijeni se çfarë bëhet më rastin kur ai i është referuar një institucioni tjetër.
- Ofrimi i shërbimeve për të miturit e grupmoshës 12-14 vjeç, të cilët janë nën moshën e përgjegjësisë penale, por mund të jenë në risk për të qenë në konflikt/kontakt me ligjin. Ngritja e një sistemi rrjetëzimi të institucioneve, që kanë në fokus këtë kategori të miturish, ku shkolla të ketë një rol qendror, përbën përparësi. Në këtë linjë, përgatitja dhe trajnimi i mësuesve mbështetës, që do të punojnë me këtë kategori të miturish, përbën gjithashtu një hap të rëndësishëm për t'u ndërmarrë. Shtuar kësaj, nga prindërit u rekomandua që të organizohen më shumë takime të përbashkëta me mësuesit, prindërit dhe të rinjtë/fëmijët për trajtimin e risqeve që i shtojnë fëmijët të bien në konflikt dhe kontakt me ligjin.
- Pjesëmarrja në takimet e Grupeve Teknike Ndërsektorale (GTN) duhet të jetë më gjithëpërfshirëse. Për shkak të ngarkesës, ka raste që institucione të ndryshme nuk përfaqësohen në GTN dhe kjo ndikon negativisht në ecurinë e bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Mungesa e bashkëpunimit të prindërve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin dhe atyre në situata risku me institucionet që ofrojnë shërbime për këtë kategori të miturish. Lipset një punë ndërgjegjësuere e madhe me prindërit për t'i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e qasjes ndërdisiplinore në funksion të përmirësimit të jetës së fëmijëve të tyre e për rrjedhojë edhe të familjes së tyre në një kuptim më të gjerë.

Programet e prindërimit pozitiv (me qasje të disiplinimit pozitiv dhe barazisë gjinore në rolet në familje) gjatë procesit të menaxhimit të rastit janë një mundësi e shkëlqyer që mbeten ende të pashfrytëzuara për t'iu dhënë prindërve njohuri, këshilla dhe informacione në mënyrë që ata të tregohen më bashkëpunues në dobi të interesit më të lartë të fëmijës. Qasja me bazë evidencën dhe përvojën e këtij programi vjen në ndihmë të partnerëve dhe aktorëve, që punojnë në këtë fushë, të replikojnë programe të ngjashme dhe të promovojnë prindërimit pozitiv për të miturit në konflikt me ligjin, si një mënyrë për të adresuar disa probleme në të njëjtën kohë: uljen e nivelit të dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje, promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në krime dhe uljen e probabilitetit të recidivizmit midis të rinjve, uljen e nivelit të vulnerabilitetit dhe viktimizimit të fëmijëve dhe promovimin e një shoqërie dhe komuniteteve më të paqta.

- Vështirësi të ofrimit të shërbimeve për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin për shkak të distancës së banimit të tyre me institucionet që ofrojnë shërbimin.
- Tradita e bashkëpunimit fisnor e komunitar dhe kontrollit social që mundësohet nga ky bashkëpunim, sidomos në Pukë, lipset të promovohet në funksion të parandalimit të devijancës dhe mundësive të të miturve për të rënë në konflikt/kontakt me ligjin. Pjesëmarrësit përmendën se përgjatë 10-15 viteve të fundit, devijancat rinore që lidhen për shembull me thyerjen e xhamave të makinave, vjedhjeve etj. kanë qenë në rënie dhe kjo duhet promovuar pozitivisht. Rritja e rolit të Bashkisë në trajtimin fillestar të rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin, dhe atyre në situatë risku, dhe jo e Komisarariatit të Policisë në Pukë, përbën një procedurë, e cila vlerësohet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, pjesëmarrës në seancat trajnuese.

Përveç seminareve, aktorët lokalë (zyrtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile) kanë rritur kapacitetet në menaxhimin e integruar të çështjeve për shkak të pjesëmarrjes së tyre në takimet ndërsektoriale dhe takimet individuale me nivelin drejtues të institucioneve të zhvilluara nga ekspertiza e brendshme e partnerëve të konsorciumit<sup>1</sup>.

## **5.2. Konkluzione nga programet e ndërhyrjes dy-palëshe prind-fëmijë**

Sikurse u përmend edhe më sipër, një komponent i këtij projekti lidhet me programet e ndërhyrjes dypalëshe prind-fëmijë. Duke standardizuar instrumentet matës, me qëllimin për të matur nivelin e të kuptuarit dhe ndryshimin e njohurive të pjesëmarrësve për temat e ofruara, instrumenti i testeve paraprake dhe atyre pas seancave trajnuese u përdor edhe në seminarët trajnuese dhe workshopet me prindër e të mitur.

---

<sup>1</sup> 1st\_Progressive\_Report\_Oct-Dec21\_AFRCR-CDC-TFF

Prindërit dhe të rinjtë u inkurajuan të mendonin në lidhje me faktorët që gjenerojnë sjellje konfliktuale ose situata që çojnë në konflikt, të mendonin se si mund t'i identifikojnë këta faktorë dhe më tej se si mund t'i lehtësojnë, devijojnë ose raportojnë ato. Përmes matjeve me instrumentet e vlerësimit vërehet se:

- ✓ Përafërsisht. 90% e prindërve dhe të rinjve pranuan se mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm gjenerojnë faktorë shtytës për sjellje konfliktuale
- ✓ Pothuajse 100% e tyre ishin në gjendje të identifikonin faktorët shtytës të mjedisit të jashtëm si mjedisi i shkollës, presioni i bashkëmoshatarëve, mediat sociale, stereotipet, situata Covid-19, varfëria e përgjithshme, etj.
- ✓ 40% e pjesëmarrësve përmendën faktorët shtytës të mjedisit të brendshëm (familja), megjithatë ata ende i lidhën me faktorët e jashtëm: për shembull - dhuna në familje - por për shkak të varfërisë dhe situatës së përgjithshme
- ✓ Përafërsisht 68% e nënave dhe 59% e baballarëve pranuan se përdorin stil autoritar/demokratik.

Rezultatet e testeve nxorën në pah se:

- ✓ Përafërsisht. 80% e prindërve ishin në gjendje të demonstrojnë zbatimin e koncepteve pas seminarit të parë, përmirësuar në 85% pas seminarit të tretë.
- ✓ 75% e fëmijëve dhe të rinjve ishin në gjendje të demonstrojnë zbatimin e koncepteve.
- ✓ Prindërit theksuan se informacioni është i nevojshëm, pasi ata e shohin veten si një pikë kyçe në edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të tyre. Po kështu, kyç u konsiderua edhe roli i mësuesve. Duke patur parasysh këtë, prindërve iu rekomandua që të bënin më shumë takime të përbashkëta me mësuesit, prindërit dhe të rinjtë/fëmijët.
- ✓ Për sa i përket roleve gjinore, zbatimi mbetet ende një sfidë për shkak të mentalitetit patriarkal, megjithatë prindërimi i mirë u përqaftua nga të gjithë prindërit dhe fëmijët dhe pothuajse 100% e tyre ishin të informuar për normat gjinore.

### **5.3. Konkluzione nga testet para dhe pas veprimtarive argëtuese me të rinjtë**

Një tjetër komponent vlerësimi kishte të bënte me perceptimet nga ana e të rinjve në lidhje me rolin e formave krijuese artistike, si modele pozitive që i largojnë të rinjtë nga rruga e devijancës dhe delinkuencës. Nga këto perceptime mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- ✓ Pas interpretimit në skenë të dramës, përpara bashkëmoshatarëve, prindërve, përfaqësuesve të institucioneve dhe anëtarëve të komunitetit, 100% e tyre ndihën shumë të sigurt dhe shumë të lumtur për të interpretuar minidramën “Besmir” dhe për ta vënë në skenë në shkollën e ndryshme të Pukës, Fushë-Arrëzit, Shkodrës etj.

- ✓ Njohja e të drejtave dhe detyrimeve të përditshme nëpërmjet formave krijuese dhe stimulimit të artit është një mënyrë efektive për të vepruar dhe jetuar në përputhje me vlerat, normat dhe ligjet në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që brezi i ri të jetë pjesë aktive dhe qytetar model i një shoqërie të qytetëruar shqiptare, dhe rezultatet treguan se:
- ✓ Format krijuese si fotografia, piktura, vizatimi, teatri, arti dramatik u përfaqëuan nga pjesëmarrësit si mënyrat më efektive për të shprehur ndjenjat, mendimet dhe mënyrat se si të përmirësohen dhe të shprehin edukimin nga bashkëmoshatarët.
- ✓ Të 8 takimet e zhvilluara kanë kontribuar në rritjen e shoqërizimit të tyre, duke krijuar modele pozitive për bashkëmoshatarët, duke zgjeruar njohuritë, duke ndërmarrë nisma të reja, duke zhvilluar kapacitetet e tyre në aktrim, art, vizatim, ese, poezi etj.
- ✓ Dinamika e të rinjve ishte shumë pozitive dhe klima e krijuar u mundësoi atyre të jenë më të hapur për të shprehur mbrojtjen e të drejtave të tyre, bashkëpunimin me prindërit dhe familjet, shkollën, institucionet dhe të bëhen zëri i të miturve në konflikt/kontakt me ligjin. viktimave dhe atyre në rrezik.

#### **5.4. Konkluzione nga takimet trajnuese dhe workshopet me nxënësit në lidhje me komponentin e zgjidhjes së konflikteve**

Nxënësit në këto programe trajnuese treguan interes në rritje për aspekte të ndryshimeve ligjore në fushën e drejtësisë për të mitur, dhe posaçërisht për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, që ka hyrë në fuqi në vitin 2018, për shmangien e të rinjve nga procedimet penale për një sërë kategorish veprash penale të parashikuara në Kod, për masat alternative dhe veçanërisht të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, ndërmjet viktimave dhe të akuzuarve në veprat penale. Veçanësi e komponentit të zgjidhjes së konflikteve në shkolla ishte pjesëmarrja aktive e vetë nxënësve në përgatitje skenarësh dhe luajtje rolesh duke demonstruar aftësi në përdorimin e rrethit të paqes dhe dialogut restaurues në trajtimin dhe zgjidhjen paqësore të situatave konfliktuese karakteristike për grupmoshat shkollore.

Lidhur me perceptimin e nxënësve rreth të kuptuarit e konfliktit dhe situatës konfliktuese, nëpërmjet testeve të bëra para trajnimeve dhe workshopëve ndërgjegjësuese vihet re se:

- ✓ Vetëm 40 për qind e tyre kanë dhënë përgjigje mesatarisht të kënaqshme, ndërsa për të njëjtën pyetje të bërë në fund të aktiviteteve në shkolla rreth 95 për qind e nxënësve kanë dhënë përgjigje më të plotë.
- ✓ Gjithashtu në fillim të aktiviteteve, pothuajse vetëm 10 për qind e nxënësve i janë përgjigjur saktë se çfarë kuptojnë ata me shmangie nga procedura ndëshkuese/penale, ndërkohë në fund kuptueshmëria është rritur në mbi 90 për qind.

- ✓ Shumica e nxënësve pjesëmarrës në nisjen e aktiviteteve në shkolla jepnin një përgjigje të përgjithshme kur pyeteshin se kush janë disa nga format paqësore të zgjidhjes së konflikteve, ndërkohë që në fund të programit 98 për qind ishin në gjendje t'i identifikonin këto instrumente.

### **5.5. Refleksione nga intervista me profesionistë, ofrues shërbimesh për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin**

Sikurse u përmend edhe më sipër, për të përmbushur qëllimin e këtij libërthi elektronik, u intervistuan 11 profesionistë që ofrojnë shërbime për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin.

Intervistat u fokusuan në hulumtimin e 5 çështjeve kryesore, sipas një udhëzuesi gjysmë të strukturuar<sup>2</sup>, megjithatë përgjatë intervistave u gjeneruan dhe ide përtej tematikave të parashikuara, gjë që e diktoi vetë fleksibiliteti i intervistës.

- Shfrytëzimi i hapësirave që Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit ofron, për të ndihmuar zbatimin e një drejtësie miqësore për të miturit.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional për trajtimin e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin.
- Përfshirja në trajnime /kualifikime që kanë në fokus qasjen ndërdisiplinore të mbështetjes për të miturit në konflikt kontakt me ligjin.
- Sfidat ose nevojat që mund t'ju lindin në lidhje me zbatimin e një qasjeje ndërdisiplinore e ndërinstytucionale të fëmijëve në konflikt /kontakt me ligjin.
- Përfitimi profesional i ofruesve të shërbimeve nga pjesëmarrja në këtë projekt.
- Zbatimi i programeve tripalëshe fëmijë-prindër-institucione për të ndarë praktika dhe rekomandime.

Më poshtë janë shtjelluar perceptime dhe ide nga intervistat me profesionistët e intervistuar.

- a. Shfrytëzimi i hapësirave që Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit ofron, për të ndihmuar zbatimin e një drejtësie miqësore për të miturit.*

Profesionistët theksojnë se KDPM përbën një risi që, nga njëra anë e ka lehtësuar punën e tyre, sepse lehtëson institucionet e zbatimit të drejtësisë penale, por nga ana tjetër, janë hasur disa paqartësi në mënyrën se si mund të zbatohet praktikisht KDPM nga profesionistët.

---

<sup>2</sup> Shih: Shtojca 3

Megjithatë të intervistuarit vlerësojnë pozitivisht projektin “Forcimi i qasjes ndërdisiplinore në menaxhimin e rasteve për fëmijët në konflikt dhe në kontakt me ligjin”, i cili i ka ndihmuar të praktikojnë elementë që lidhen me qasjet ndërdisiplinore restauruese.

Një profesioniste e përfshirë në projekt pohon:

*“Nëpërmjet implementimit të projektit, kemi filluar ta shohim zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit me një qasje ndryshe. Pra nuk është se e kemi parë vetëm në aspektin e zbatimit procedural, pra jo vetëm në lidhje me institucionet që japin drejtësi, por risi ka qenë sensibilizimi dhe ndërveprimi ndërmjet institucioneve, bashkërendimi i detyrave dhe përgjegjësive të gjithsecilit nga profesionistët, në mënyrë që produkti të ishte shmangia nga dënimi i të miturve. Pra projekti, i fokusuar tek dimensionin social, po jetëson elementë të KDPM” (Juriste, Shkodër).*

Të intervistuarit gjithashtu nxjerrin në pah një prioritet që lidhet me vullnetin e profesionistëve për të zbatuar qasjen restauruese të ofruar nga KDPM. Ja si shprehet një profesionist i intervistuar:

*“Kam vënë re se prokurori i ri, që ka ardhë këtu në Pukë, është shumë pro zbatimit të masave restauruese për të miturit. Unë jam në dijeni të 4 rasteve të të miturve, për të cilat prokurori ka propozuar masa shmangëse. Dubet theksuar se një mbështetje e mirë ka qenë në këtë pikë edhe psikologjia e Prokurorisë. Ajo është shpesh e pranishme në trajnimet që janë bërë për të njohur nga afër zbatimin e KDPM. Është shumë e rëndësishme kur punonjësit e një institucioni mbështesin njeri-tjetrin dhe bëjnë më të mirën për të miturit.” (Përfaqësues i Shërbimit të Provës, Pukë).*

#### ***b. Bashkëpunimi ndërinstitucional për trajtimin e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin***

Profesionistët e intervistuar e vlerësojnë qasjen ndërdisiplinore të trajtimit të të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin si një risi, e cila duket se po jep shenjat e para të suksesit.

Një i intervistuar në rolin e mentorit, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional, në funksion të efikasitetit të qasjes ndërdisiplinore tek të miturit në konflikt/kontakt me ligjin, duke u shprehur si më poshtë:

*“Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Shërbimin e Provës. Ky institucion, e ka kuptuar qartë rëndësinë e referimit të rasteve të të miturve në konflikt me ligjin në procesin e mentorimit. Bashkëpunimi ndërinstitucional është një pikë e fortë, e cila është nxitur nga ky projekt. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi kemi arritur të eksplorojmë aftësitë e fëmijëve, për rastet që po trajtojmë dhe t'i zgjojmë ato, sepse shpesh janë të fjetura.” (Mentor, Pukë)*

Të intervistuarit theksojnë rëndësinë e zbatimit të këtij projekti në bërjen funksionale të këtij bashkëveprimi institucional. Ja si shprehet një i intervistuar:

*“Me thënë të drejtën kisha pak kohë që i bëja shkresa zyrës së punës... U desh ndërhyrja e projektit që të vibeshin në lëvizje aktorët ndërdisiplinorë dhe që zyra e punës të reagoje. Patjetër që nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit përbën një produkt me shumë vlerë të projektit dhe një mekanizëm shumë efikas që vë në lëvizje këtë bashkëpunim”. (Përfaqësues i Shërbimit të Provës, Pukë).*

Nga intervistat me profesionistë të përfshirë në programin e riintegritimit nëpërmjet qasjes ndërdisiplinore, është vënë re se në qytetet e vogla, e konkretisht në Pukë ekziston një përparësi, e cila duhet shfrytëzuar pozitivisht. Njohjet e profesionistëve me njeri-tjetrin janë në funksion të trajtimit sa më cilësor të ofrimit të shërbimeve për të miturin, duke ndihmuar kështu kapërcimin e sfidave me të cilat haset zbatimi i qasjes ndërdisiplinore, në funksion të riintegritimit të të miturve në lokalitete.

*“Ne kemi si të them “komoditetin” që nuk kemi shumë raste, kështu që ato pak raste që kemi ne i trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Psh., duke qenë qytet i vogël, ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me institucionet. Sipas KDPM, ne duhet ta trajtojmë rastin e një të mituri në momentin kur dosja tek ne merr numër procedimi, që do të thotë që i mituri, pasi të intervistohet në komisarariat do të intervistohet edhe këtu tek ne nga prokurori, oficeri apo unë. Unë përpiqem të asistoj intervistën edhe në komisarariat sepse komisarariat nuk ka psikolog të licencuar dhe ky ka qenë një ngërç. Unë kam bashkëpunuar me komisarariat, në mënyrë që të mos e zvarrisim çështjen, sepse të miturit vijnë nga zona shumë të largëta, po përmend për shembull zonën e Fierzës, që ne nuk kemi as transport publik e po të vijë një i mitur me transport privat i kushton shumë, kështu që ne si profesionistë, përpiqemi ta lehtësojmë procesin.”. (Psikologe në Prokurorinë e Rrethit, Pukë).*

Një tjetër profesionist thekson rëndësinë e referimit të rasteve dhe menaxhimit të tyre sipas qasjes multidimensionale, si tregues të suksesit të këtij projekti.

*“Shërbimi social, por edhe policia e kanë vënë në jetë tashmë Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Këto institucione kanë identifikuar raste të të miturve, të cilëve, me ndërhyrjen e projektit, po u ofrohet ndihmë psikologjike, ligjore, shërbimi i ndërmjetësimit, aftësim për jetën, por edhe mbështetje të një natyre ekonomike. Një pjesë e këtyre të miturve vijnë nga familje me status socio-ekonomik jo të mirë që kanë nevojë për mbështetje shumëdimensionale, në funksion të mirërritjes së fëmijëve të tyre” (Mentor, Shkodër).*

Këtë urë bashkëpunimi të ngritur në funksion të riintegritimit dhe përmirësimit të jetës së fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin dhe atyre në situata rrisht, profesionistët e konsiderojnë si një model shumë të mirë, i cili duhet të zbatohet në punën e tyre përditshme, jo vetëm me të miturit. Ky bashkëpunim, i kthyer në një filozofi pune për institucionet, do ta rriste efikasitetin e shërbimeve që ata ofrojnë për të gjithë qytetarët.

***c. Përfshirja në trajnime / kualifikime që kanë në fokus qasjen ndërdisiplinore të mbështetjes për të miturit në konflikt kontakt me ligjin.***

Të gjithë të intervistuarit kanë pohuar se kanë marrë pjesë në seancat trajnuese të zhvilluara në kuadrin e këtij projekti dhe i vlerësojnë ato shumë efikase. Disa prej tyre shprehen se kanë marrë pjesë edhe në trajnime të tjera të mëparshme, të cilat kanë pasur në fokus shërbimet ndaj të miturve në konflikt/kontakt me ligjin, por, si të thuash, ato kanë qenë disi më të segmentura dhe të fokusuara në tema specifike. Për ta, qasja ndërdisiplinore në trajnimet e ofruara në këtë projekt, ka një vlerë të veçantë.

Të intervistuarit theksuan faktin që, kur trajnime të tilla shoqërohen edhe me përvojë praktike, sikurse u mundësua nga ky projekt, atëherë ajo çka jepet disi teorikisht në trajnim, si të thuash “preket me dorë” praktikisht dhe rezultatet shihen drejtpërdrejt te grupi i synuar, e në këtë rast te të miturit në konflikt/kontakt me ligjin.

***d. Sfidat ose nevojat që mund t’ju lindin në lidhje me zbatimin e një qasjeje ndërdisiplinore e ndërinstucionale të fëmijëve në konflikt / kontakt me ligjin.***

Përgjatë intervistave, profesionistët ofrues shërbimesh për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin përmendin disa sfida që lidhen me ofrimin e qasjes ndërdisiplinore në funksion të përmirësimit të jetës së të miturve në konflikt/kontakt me ligjin si dhe atyre në situatë risku. Këto sfida të identifikuara përgjatë intervistave janë listuar më poshtë:

- Ka mungesë të informacionit nga ana e prindërve të të miturve, e për rrjedhojë, edhe mungesë të të kuptuarit të rëndësisë së pjesëmarrjes së fëmijëve të tyre në programe riintegrimi dhe restaurimi. Kështu, prindërit shpesh kanë heziturar të vinin nëpër takime. Ndiqma psikologjike në ndonjë rast nuk është mirëpritur nga prindërit, krahasuar me ndihmën logjistike dhe ekonomike e cila është konsideruar më e nevojshme nga familjet e të miturve.
- Tryezat vendore duhet të jenë periodike, sepse është shumë e rëndësishme mbajtja gjallë e frymës së bashkëpunimit. Vendosja e detyrave për aktorët e angazhuar në qasjen ndërdisiplinore të shërbimeve dhe monitorimi i ecurisë së tyre është shumë i domosdoshëm.
- Duhet të evitohet mbivendosja e funksioneve mes aktorëve të ndryshëm që ofrojnë shërbime për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin, për shembull intervistimi i të miturve nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme lipset të menaxhohet më mirë. I mituri mund të kontaktohet nga shumë persona dhe kjo situatë mund të japë efektin e kundërt. Duhet të shmangët ofrimi i shërbimeve në mënyrë kaotike.
- Bashkëpunimi mes shkollave dhe institucioneve të tjera lipset të forcohet, sidomos për kategorinë e të miturve në situatë risku. Ky bashkëpunim dhe programe tripalëshe mësues-prind-fëmijë do t’i shërbenin parandalimit të të miturve për të rënë në konflikt/kontakt me



ligjin. Praktikrat e policimit në komunitet, mund të ndikojnë pozitivisht për të forcuar këtë bashkëpunim.

- Është e nevojshme që të gjenden mekanizma që plani i ndërhyrjes të jetë i shtrirë në kohë, sipas nevojave të të miturve për shërbime, dhe jo i ndikuar nga kohëzgjatja e projektit.
- Është e nevojshme që ofrimi i shërbimeve të integruara të jetë i qëndrueshëm. Projekti mund të shërbejë si një fazë pilot, por pasi të evidentohet efikasiteti i kësaj qasjeje, del e nevojshme krijimi i mekanizmave për ta bërë qasjen të zbatueshme në vazhdimësi.

#### ***e. Përfitimi profesional i ofruesve të shërbimit nga pjesëmarrja në këtë projekt***

Përfitimet nga projekti shihen sipas këndvështrimeve të ndikuara nga rolet në të cilat përfshihen profesionistët.

*“Unë ndjej se jam më i informuar dhe më i orientuar praktikisht tani për drejtësinë miqësore për të miturit dhe qasjen multidisiplinore të trajtimit të tyre. Jam trajnuar dhe më parë, por tani ndjej që ka ardhë koha që ajo çka marrim nga trajnimet të bëhet realitet. Mendoj që kjo qasje e ofruar mund të integrohet në programin e policimit në komunitet që ne ofrojmë në punën tonë”. (Oficer policie, Pukë)*

Një nga mentorët e angazhuar në projekt e përshkruan si më poshtë përfitimin e tij profesional.

*“Nga ky projekt mund të them që edhe unë vetë përfitova një përvojë të re: atë të mentorimit. Krijimi i profilit të mentorit ka qenë shumë interesant dhe risi gjithashtu. Në njërin nga rastet që po mentoroj, pasi kam evidentuar pikat e forta të të miturit, jam përpjekur ta drejtoj atë me kujdes që resurset që ai ka dhe që i përdorte në drejtimin jo të duhur, të mund t'i përdorë në mënyrë konstruktive. Kështu, mentorim, i nga njëra anë, dhe forcimi i kapaciteteve të të miturve, por edhe e familjeve të tyre, nga ana tjetër, mendoj se janë pikat më të forta të zhvilluara në kuadrin e këtij projekti.” (Mentor, Shkodër).*

Një tjetër mentor, gjatë intervistës së tij pohon:

*“Unë ndjej se përvoja ime si mentor, në këtë projekt është frytdhënëse dhe ndihem optimist që, nëpërmjet projektit po ndihmojmë njerëz. Kjo më bën të ndihem i vlefshëm” (Mentor, Pukë).*

Të intervistuar të tjerë e shohin përfitimin e tyre profesional nga projekti të lidhur në një plan më të gjerë, në funksion të familjeve të të miturve dhe të komunitetit. Ja si shprehen disa prej tyre:

*“Unë mendoj që ne patjetër kemi përfitur profesionalisht, kemi fituar një përvojë të re, nëpërmjet përfitimit që kanë patur fëmijët dhe familjet e tyre. Kujtoj madje një rast kur edhe prindi donte të futej në kurs profesional me të miturin” (Oficer policie, Pukë)*

*“Mua më shqetëson fakti që këtu në Pukë kanë munguar shërbimet e integruara dhe kejo e bën të vështirë adresimin e nevojave të të miturve në kontakt e konflikt me ligjin. Projekti përbën një investim të rëndësishëm në lidhje me mbushjen e këtij hendeku dhe një vlerë të shtuar për komunitetin e Pukës. Ndihem e vlerësuar që isha pjesë e tij”. (Psikologe në Prokurorinë e Rrethit, Pukë).*

**f. Zbatimi i programeve tripalëshe fëmijë-prindër-institucione për të ndarë praktika dhe rekomandime.**

Edukimi i të miturve në kontakt apo në konflikt me ligjin kërkon një proces të vazhdueshëm dhe të ndërthurur, që çon në një sjellje të përmirësuar. Megjithatë, në varësi të shkallës së sjelljes devijante të të miturit dhe faktorëve influencues, përveç trajtimit në grup, ka nevojë dhe për trajtim individual shtesë me bazë familjen.

Qasja inovative e projektit, përmes implementimit të praktikave të prindërimit/disiplinimit pozitiv, barazisë gjinore në rolet në familje dhe shoqëri, vlerësohet nga profesionistët dhe shihet me vlerë që gjatë ndërhyrjeve për trajtimin e të miturve në risk/konflikt me ligjin, përveç trajnimeve përkatëse, sipas rastit trajtimi të përfshijë:

- ✓ Aspektin e ndërtimit të marrëdhënieve në familje, si faktorë të mjedisit të brendshëm të të miturit;
- ✓ Aspektin e ndërtimit të marrëdhënies prind – të mitur, si faktor mbështetës dhe kontribues në qëndrueshmërinë e qëndrimit të ri konform ligjit;
- ✓ Aspektin e krijimit të efektit amplifikues në mjedisin e jashtëm të të miturit, nëpërmjet angazhimit dypalësh prind-të mitur në aktivitete sociale/komunitare/ndërgjegjësuere.

## **5.6. Këndvështrime nga përfituesit**

Sikurse u theksua edhe më sipër, qasja multifunksionale e ofrimit të shërbimeve për të miturit në konflikt e kontakt me ligjin ose dhe për fëmijët në risk, konsistoi në ofrimin e disa plane:

- ndihmë juridike;
- këshillim dhe ndihmë psikologjike;
- shërbime ndërmjetësimi dhe praktika restauruese;

- formim profesional dhe rritje kapacitetesh;
- mentorim dhe aftësim për jetën;
- mbështetje logjistike dhe ekonomike;
- mundësi punësimi për të miturin ose një anëtar të familjes.

Për të përmbushur më mirë qëllimin e këtij libërthi, u realizuan biseda të lira me 4 të mitur përfitues, 2 djem e 2 vajza, 3 të mitur nga Shkodra e 1 nga Puka.

Gjatë bisedave, të miturit shpreheshin të kënaqur nga shërbimet ndërdisiplinore që u ishin ofruar në kuadër të projektit.

*“E vlerësoj shumë që mentori mbështeti atë çfarë mua më pëlqente të bëja dhe më krijoi mundësinë të ndiqja kursin profesional. Për mua do të jetë mirë, sepse do bëj dhe njohje të reja me çunat e tjerë që ndjekin kurse aty” (i mitur përfitues, Pukë).*

Një tjetër e mitur përfituese nga shërbimet e ofruara në kuadër të këtij projekti shprehet:

*“Unë kam përfituar ndihmë psikologjike. Jam ndjerë shumë mirë në seancat me psikologun. Nuk e kisha menduar më parë sa nevojë kisha patur për këtë shërbim. Mendoj se çdo njeri në faza të ndryshme të jetës, duhet t’i drejtohet psikologut...” (Përfituese, 17 vjeçe, Shkodër).*

Për të miturit vlerësohet pozitivisht puna me mentorin dhe afërsia që krijohet me të. Shpesh reputacioni pozitiv që mentori, si profesionist, ka në komunitet, përbën një përparësi dhe ndihmon në efikasitetin e punës me të miturin.

Pavarësisht se të miturit e intervistuar ishin ende në proces mentorimi dhe merrnin shërbime të ndryshme, ata shprehen se kishin filluar t’i ndjenin rezultatet e këtyre shërbimeve.

*“Ndihem më mirë tani me veten dhe më të tjerët. Madje nga kejo përvojë kam ndërtuar një projekt për të ardhmen time: Dua të bëhem psikologe sepse dua të ndihmoj njerëzit, ose politikane sepse dua të ndryshoj vendin e t’u vij në ndihmë sidomos grave dhe femijëve” (Përfituese, 17 vjeçe, Shkodër)”.*

## 6. HISTORI SUKSESI

### Rasti 1

I mituri, 17 vjeç, ka pasion makinat dhe mjetet motorike dhe aktivitetin më të madh të ditës e organizon lidhur me to: ndihmon shokët në riparimin e mjeteve, shoqëron xhaxhain që merret me transport pasagjerësh, njihet me karakteristikat dhe tipet e reja të makinave që dalin në treg etj. I mituri, i nxitur dhe nga nevojat ekonomike, kryen një vjedhje të dy motorëve dhe i shet ato.

Bazuar në KDPM, rasti është referuar në shërbimin ndërdisiplinor nga komisariati i policisë së Shkodrës.

Mentori, pasi është njohur me rastin dhe nga bisedat me të miturin, ka zbuluar pasionin e të miturit për makinat dhe, pasi ka shqyrtuar alternativat, ka propozuar që i mituri të ndjekë një kurs 3 mujor, ku të aftësohej për lyerjen e makinave të dëmtuara. Gjithashtu, përgjatë këtij procesi të miturit i është ofruar edhe këshillim psikologjik dhe orientim sipas pikave të tij të forta.

Gjatë 3 muajve ndjekje është vënë re dëshira e të miturit për të mësuar praktikisht dhe për të patur në një mini servis të tij, ku atësitë e përdorura në mënyrë devijante, të mund t'i shfrytëzojë pozitivisht në të mirë të tij, familjes dhe komunitetit.

Një tjetër përfitim i rëndësishëm për të miturin nga ky projekt është edhe pajisja e tij me një set veglash pune me një vlerë prej 70 mijë lekësh të rinj, që ai mund t'i përdorë për të ushtruar profesionin e fituar në mjediset e mini servisi në mjedisin e shtëpisë private të prindërve të tij. Lista e përzgjedhjes së veglave i është lënë të miturit, duke u bazuar në nevojat që ai ka. Është menduar se kjo formë përfshirjeje do të rrisë angazhimin dhe dëshirën në rrugëtimin e filluar nga ai, si protagonist i zgjedhjeve dhe marrjes së përgjegjësisë personale. Roli i mentorit në këtë rast është mbështetës dhe jo diktues.

I mituri shprehet tepër entuziast për përfitimin nga ky projekt, por edhe mentori shprehet optimist për kanalizimin e pasionit të të miturit, sipas një qasjeje produktive dhe me perspektivë për të ardhmen e tij. Krijimi i një klime të mbështetur në besim dhe përkrahje duket se po jep rezultat.

*“Mentori ka ba boll për mu. Unë e njihja dhe më parë atë. M'u ba qejfi që ai do më ndihmonte. Ai fillimisht më ka kësbillu e më ka ndihmu që të dilja nga rruga ku isha fut. Në Shkodër ne njihena me njani-tjetrin, dhe nga njena anë është mirë e nga ana tjetër jo fort, se çdo gjë që ban merret vesh, megjithatë mentori ma ka zbut shumë situatën, më ka ndenj afër e më ka trajtu si shok. Sa të hapi servisin tim, të parit që do t'ia lyj makinën do jetë ai [qesh]” ( i mitur përfitues, 17 vjeç, Shkodër).*

Gjatë këtij rrugëtimi kanë qenë të përfshirë dhe familjarët, të cilët kanë shprehur vullnetin për të punuar në skuadër.

Këto forma ndihmojnë në rritjen e vetëbesimit dhe orientimit të rrugëve alternative për mos ripërsëritur sjellje të mëparshme në konflikt me ligjin.

## Rasti 2

Rasti është referuar në shërbimin ndërdisiplinor nga Zyra e Shërbimit të Provës në Pukë. I mituri 17 vjeç, ka kryer një kundërvajtje penale, jo të një rrezikshmërie të lartë shoqërore.

Mentori shprehet se, që në takimi e parë ka vënë re se i mituri ka pasur një komunikim shumë të mirë dhe ka qenë shumë i gatshëm për të bashkëpunuar. Janë realizuar me të takime me qëllim krijimin e një marrëdhënieje të hapur, mbështetëse në funksion të këshillimit, të zhvillimit të aftësive jetësore e sociale.

Është realizuar një proces që lidhet me krijimin e një profili personal të të miturit, nëpërmjet aktiviteteve që kanë pasur në përmbajtje elementet e vetëvlerësimit, komunikimin, motivimin, eksplorimin e botës së punës, njohjen e vetes, njohjen dhe praktikimin e aftësive “start smart”, krijimin dhe zhvillimin e empatisë si dhe socializimin (përshtatjen në grup) dhe marrëdhënien me të tjerët në mjedisin ku banon.

Mentori, në bashkëpunim me të miturin ka hartuar një priorizim të aftësive, konkretisht janë listuar nga ana e të miturit pasione që kanë të bëjnë me sportin në përgjithësi, teknologjinë dhe elektroteknikën në tërësi (që përfshin shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike).

Mbështetur në nevojat e identifikuar, është punuar paralelisht me institucionet vendore për të krijuar hapësirën që i mituri të mund t'i zhvillojë dhe t'i ushtrojë këto nevoja. Mungesa e shumëllojshmërisë së programeve që ofrohen në nivel vendor ka kufizuar dhe kanalizimin e mundësive, por, në dakordësi edhe me të miturin si dhe me Qendrën e Formimit Profesional (QFP) në Pukë, është bërë e mundur që të realizohet referimi dhe ndërmjetësimi për kursin e “Shërbimeve dhe mirëmbajtjes së rrjetit elektrik”.

Programi përkatës është ofruar për afro katër muaj (maj-gusht 2022). Kursi i formimit profesional është realizuar në Kabinetin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes Elektrike, pranë QFP Pukë. Konkretizimi i këtij procesi dhe objektivi i tij është mirëpritur shumë mirë nga i mituri, nga i cili është shfaqur interes për të qenë sa më aktiv dhe për ta ndjekur kursin sipas kalendarit të përcaktuar. Lipset të theksohet se vështirësia kryesore e të miturit ka qenë largësia e vendbanimit nga QFP. Gjatë takimeve të drejtpërdrejta me të miturin është komunikuar vazhdimisht mbi vijimësinë, elementet e përfituar gjatë kësaj kohe, përvojën e fituar, vlerën e njohjes me njerëz të rinj, etj. Nga vlerësimi i realizuar konstatohet që ka një gjithëpërfshirje të mirë sociale të të miturit, një dëshirë në rritje për zhvillimin e tij profesional, për shoqërizim me njerëzit, e veçanërisht me bashkëmoshatarët në mjedisin e kursit. Gjithashtu, instruktori i kursit profesional ka evidentuar një progres praktik të të miturit në zbatimin e njohurive në lidhje me menaxhimin e rrjetit elektrik.

Një tjetër element i rëndësishëm i mbështetjes së ofruar për të miturin është dhe blerja e një kompleti profesional të materialeve elektrike, i cili do shërbejë për ta mbështetur të miturin në praktikimin e profesionit që ai po merr. Angazhimi praktik i të miturit për të jetësuar njohuritë e marra do të mundësohet edhe nga kompanitë që ushtrojnë aktivitetet në Pukë, të cilat do ta përfshijnë të miturin në aktivitetet që ato ushtrojnë.

I mituri e vlerëson shumë pozitivisht përfshirjen në këtë program dhe ndjen se ka fituar aftësi të reja, falë përvojës së përftuar, komunikimit me bashkëmoshatarët që kanë interesa të përbashkëta, kursit profesional në të cilin është përfshirë dhe mentorimit të ofruar me kujdes.

## 7. SFIDA TË IDENTIFIKUARA NGA ZBATUESIT E PROJEKTIT

Nga bisedat e lira me përfaqësues të organizatave zbatuese të projektit, si dhe nga hulumtimet e raporteve periodike të përgatitura nga këto organizata, janë identifikuar disa sfida të zbatimit të projektit së bashku me disa sugjerime për kapërcimin e tyre.

Një sfidë lidhet me angazhimin e institucioneve në tryezat dhe seminarët trajnuese të organizuara në kuadrin e projektit. Për shkak të mbingarkesës së punës, jo gjithmonë në këto aktivitete morën pjesë profesionistët e duhur, por delegoheshin profesionistë që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me të miturit në konflikt/kontakt me ligjin. U vu re së në aktivitetet e zhvilluara në Pukë, edhe për shkak të ngarkesës më të moderuar të punës në institucionet e këtij qyteti, kishte një pjesëmarrje më të gjerë të profesionistëve dhe madje edhe të vetë Kryetarit të Bashkisë së Pukës.

Sfida të tjera të hasura nga organizatat zbatuese të projektit lidhen me menaxhimin e rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin:

- Një sfidë e hasur në praktikë e lidhur me shërbimin psikologjik, është nevoja për një periudhë më të gjatë këshillimi. Shërbimi që mund të mbështetet nga projekti është i kufizuar në kohë dhe financiarisht sipas nevojës. Gjithashtu, fëmijët që ndodhen në konflikt/kontakt me ligjin ose në situata rreziku, vijnë nga familje që jetojnë në vështirësi sociale dhe ekonomike. Prandaj, shërbimet ndaj fëmijës duhet të shoqërohen me mbështetje psikologjike ndaj familjes dhe fëmijëve të tjerë në familje.

- Në muajt e parë (tetor-nëntor-dhjetor 2021), partnerët hasën vështirësi në identifikimin dhe referimin e rasteve, por pasi u intensifikua komunikimi dhe bashkëpunimi mes tyre dhe zbatuesve të projektit, veçanërisht me bashkitë (Drejtoria e Shërbimeve Sociale) dhe Shërbimin e Provës, u mundësua identifikimi i rasteve dhe ofrimi i shërbimit për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin dhe në situata rreziku për të qenë të tillë.

Për të adresuar këto sfida, me mbështetjen e Konsulentit të UNICEF për Drejtësinë për të Mitur, është hartuar një Marrëveshje Bashkëpunimi mbi bashkëpunimin ndërinstytucional përmes një qasjeje ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve (propozuar në tryezat e rrumbullakëta). Marrëveshja u diskutua në seminarë teknike ndërinstytucionale dhe shihet nga autoritetet përgjegjëse në nivel vendor si një udhëzues i dobishëm, si për përfaqësuesit, ashtu edhe për stafin teknik të institucioneve përkatëse për të realizuar përgjigjet ndërinstytucionale ndaj rasteve të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligji.<sup>3</sup> Marrëveshje të Bashkëpunimit ndërinstytucionale u firmosën si në Shkodër dhe Pukë, në kuadrin e këtij projekti.

---

<sup>3</sup> Shih: 1st\_Progressive\_Report\_Oct-Dec21\_AFCR-CDC-TFF

## **8. SUGJERIME PËR VAZHDIMËSINË E ZBATIMIT TË QASJES NDËRDISIPLINORE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT E KONTAKT ME LIGJIN OSE NË SITUATA RREZIKU**

Nga të dhënat e përfutuara nga aktorë të ndryshëm, pjesëmarrës në këtë projekt, mund të nxirren disa sugjerime për vazhdimësinë e zbatimit të qasjes ndërdisiplinore për të miturit në konflikt e kontakt me ligjin ose në situata rreziku

- Nevojitet ngritja e një mekanizmi të qëndrueshëm për një bashkëpunim më të mirë të institucioneve të nivelit vendor në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndërdisiplinore për të miturit në konflikt dhe kontakt me ligjin.
- Buxhetimi i shërbimeve të ofruara për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin nga institucionet e ndryshme përbën një domosdoshmëri, mungesa e të cilit shpesh shkaktohet edhe nga mungesa e bazës ligjore për buxhetimin.
- Është e nevojshme të bëhet ndjekja dhe monitorimi i rastit të të miturit në mënyrë të integruar nga institucionet, ofrues të shërbimeve.
- Ofrimi i shërbimeve duhet të mundësohet edhe për të miturit e grupmoshës 12-14 vjeç, të cilët janë nën moshën e përgjegjësisë penale, por mund të jenë në risk për të qenë në konflikt/kontakt me ligjin. Ngritja e një sistemi rrjetëzimi të institucioneve, që kanë në fokus këtë kategori të miturish, ku shkolla të ketë një rol qendror, përbën përparësi. Në këtë linjë, përgatitja dhe trajnimi i mësuesve mbështetës, që do të punojnë me këtë kategori të miturish, përbën gjithashtu një hap të rëndësishëm për t'u ndërmarrë.
- Pjesëmarrja në takimet e Grupeve Teknike Ndërsektorale (GTN) duhet të jetë më gjithpërfshirëse.
- Nevojitet një punë ndërgjegjësuere e madhe me prindërit për t'i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e qasjes ndërdisiplinore në funksion të përmirësimit të jetës së fëmijëve të tyre e për rrjedhojë edhe të familjes së tyre në një kuptim më të gjerë. Programet e prindërimit pozitiv (me qasje të disiplinimit pozitiv dhe barazisë gjinore në rolet në familje) gjatë procesit të menaxhimit të rastit janë një mundësi e shkëlqyer që mbeten ende të pashfrytëzuara për t'iu dhënë prindërve njohuri, këshilla dhe informacione në mënyrë që ata të tregohen më bashkëpunues në dobi të interesit më të lartë të fëmijës. Qasja me bazë evidencën dhe përvojën e këtij programi vjen në ndihmë të partnerëve dhe aktorëve, që punojnë në këtë fushë, të replikojnë programe të ngjashme dhe të promovojnë prindërimin pozitiv për të miturit në konflikt me ligjin, si një mënyrë për të adresuar disa probleme në të njëjtën kohë: uljen e nivelit të dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje, promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në krime dhe uljen e probabilitetit të recidivizimit midis të rinjve, uljen e nivelit të vulnerabilitetit dhe viktimizimit të



fëmijëve dhe promovimin e një shoqërie dhe komuniteteve më të paqta. Organizimi i më shumë takime të përbashkëta me mësuesit, prindërit dhe të rinjtë/fëmijët për trajtimin e risqeve që i shtyjnë fëmijët të bien në konflikt dhe kontakt me ligjin, përbën një domosdoshmëri.

- Nevojitet të promovohet tradita e bashkëpunimit fisnor e komunitar dhe kontrollit social që mundësohet nga ky bashkëpunim, në funksion të parandalimit të devijancës dhe mundësive të të miturve për të rënë në konflikt/kontakt me ligjin.
- Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi mes shkollave dhe institucioneve të tjera sidomos për kategorinë e të miturve në situatë risku. Ky bashkëpunim dhe programe tripalëshe mësues-prind-fëmijë do t'i shërbenin parandalimit të të miturve për të rënë në konflikt/kontakt me ligjin. Praktikrat e policimit në komunitet, mund të ndikojnë pozitivisht për të forcuar këtë bashkëpunim.
- Është e nevojshme që të gjenden mekanizma që plani i ndërhyrjes të jetë i shtrirë në kohë, sipas nevojave të të miturve për shërbime, dhe jo i ndikuar nga kohëzgjatja e projektit.
- Është e nevojshme që ofrimi i shërbimeve të integruara të jetë i qëndrueshëm. Projekti mund të shërbejë si një fazë pilot, por del e nevojshme krijimi i mekanizmave për ta bërë qasjen të zbatueshme në vazhdimësi.

## **9. BURIME TË PËRDORURA**

- Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit
- 1st\_Progressive\_Report\_Oct-Dec21\_AFCR-CDC-TFF
- 2nd\_Progressive\_Report\_Oct-Dec21\_AFCR-CDC-TFF
- 3rd\_Progressive\_Report\_March-May22\_AFCR-CDC-TFF

## 10. SHTOJCA

### SHTOJCA 1

#### PRE/POST TEST

#### Workshop trajnues

#### Masat alternative dhe drejtësia restauruese për të miturit në konflikt e kontakt me ligjin

##### Vlerësim i njohurive

1. A keni informacion për shmangien nga ndjekja penale?

Po

Jo

2. Nëse po, çfarë është shmangia nga ndjekja penale?

---

---

3. A i njihni masat alternative të shmangies për të miturit në konflikt me ligjin?

Po

Jo

4. Nëse po, përshkruaj disa prej tyre.

---

---

5. A keni informacion për Drejtësinë Restauruese?

Po

Jo

6. Nëse po, cili është kuptimi juaj rreth Drejtësisë Restauruese?

---

---

7. A mund të përmendni disa nga format e Drejtësisë Restauruese që janë parashikuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të miturit?

---

---

## SHTOJCA 2

### PRE/POST TEST

#### Seminar Trajnues 2-ditor

#### Drejtësia Miqësore për të Miturit - menaxhimi ndërdisiplinor i rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin

#### Vlerësim i njohurive

Për pohimet e mëposhtme, ju lutem jepni vlerësimin tuaj.

Nr	Pohimi	Po	Jo	Jepni mendimin tuaj
1	Termi <i>Drejtësi miqësore për të miturit</i> kërkon përshtatjen e proceseve mbi divorcet, kujdestarinë, a birësimin me nevojat e fëmijës, dhe nuk lidhet me drejtësinë penale.			
2	Drejtësia miqësore, për fëmijët merr në konsideratë që fëmijët të punojnë së bashku me profesionistët në mënyrën më të përshtatshme me kapacitetet e tyre të të nxënit dhe të përfshirjes aktive.			
3	Fëmijët nuk kanë të drejtë të dëgjohen për shkak të mungesës së kompetencave në moshën e tyre.			
4	Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit në Republikën e Shqipërisë, nuk merr në konsideratë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dëshmitar.			
5	Programet restauruese mund të parandalojnë ripërsëritjen e veprës penale			
6	Sipas KDPM, shmangia nuk lidhet me pushimin ndaj ndjekjes penale të të miturit në konflikt me ligjin.			
7	Vendosja nën kujdes e të miturit në konflikt me ligjin përbën një masë shmangieje, të parashikuar nga KDPM.			
8	Ndërmjetësimi është një proces, i cili nuk angazhon domosdoshmërisht një palë të tretë për zgjedhjen e konfliktit.			
9	Grupet Teknike Ndër-Sektoriale pranë Bashkive, duhet të kenë në përbërjen e tyre juristë, psikologë e punonjës socialë dhe jo profesionistë të fushave të tjera.			
10	Grupet Teknike Ndër-Sektoriale pranë Bashkive, kanë përgjegjësi në trajtimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin apo edhe familjet e tyre.			

**Ju faleminderit!**

### SHTOJCA 3

#### UDHËZUES GJYSMË I STRUKTURUAR I INTERVISTËS

Ky udhëzues interviste është hartuar në kuadër të projektit “Forcimi i qasjes ndërdisiplinore në menaxhimin e rasteve për fëmijët në konflikt dhe në kontakt me ligjin”, mbështetur nga UNICEF Shqipëri dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe i zbatuar nga Konsorciumi i organizatave: Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve dhe Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.

Të dhënat e përftuara nga kjo intervistë do të përdoren vetëm për arsye hulumtimi.

Institucioni ku punoni: \_\_\_\_\_

Funksioni juaj brenda institucionit: \_\_\_\_\_

1. Përshkruani në mënyrë të përgjithshme rolin tuaj në punën me fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

2. Tashmë Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit ka rreth 3 vite që ka hyrë në fuqi. Si i keni shfrytëzuar ju hapësirat që ky Kod ofron, për të ndihmuar zbatimin e një drejtësie miqësore për të miturit? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

3. A mund të përmendni ndonjë rast (ose disa raste) të bashkëpunimit ndërinstytucional për trajtimin e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin, ku ju dhe institucioni ku ju punoni ka ofruar mbështetje? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

4. A jeni përfshirë në trajnime /kualifikime që kanë në fokus qasjen ndërdisiplinore të mbështetjes për të miturit në konflikt kontakt me ligjin. Nëse po, përmendini ju lutem. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

5. A mund të përshkruani sfidat që ju parashikoni se mund të hasni ose nevojat që mund t’ju lindin në lidhje me zbatimin e një qasjeje ndërdisiplinore e ndërinstytucionale të fëmijëve në konflikt / kontakt me ligjin \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

6. Përshkruani përfitimin tuaj profesional nga pjesëmarrja në këtë projekt \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## SHTOJCA 4

**Drejtësia Miqësore për të Miturit - menaxhimi ndërdisiplinor i rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin**

**Pre/Post test për prindërit**

Unë do doja të përmirësoja/ndyshoja te vetja \_\_\_\_\_

	<i>Asnjëherë</i>	<i>Ndonjëherë</i>	<i>Shpesh</i>	<i>Gjithmonë</i>	<i>Pa përgjigje</i>
Unë flas hapur me fëmijën tim për çështje të ndryshme.					
Fëmija im nuk konsumon alkool, duhan dhe drogë.					
Fëmija im ka pasur probleme me ligjin (policinë, prokurorinë, gjykatën etj)					
Fëmija im respekton rregullat dhe detyrimet e tij.					
Unë shqetësohem për ndjenjat e fëmijës tim.					

## SHTOJCA 5

**Drejtësia Miqësore për të Miturit - menaxhimi ndërdisiplinor i rasteve të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin**

**Pre/Post test për fëmijët**

Unë do doja të përmirësoja/ndyshoja tek vetja \_\_\_\_\_

**Jepni opinionin tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:**

	<i>Asnjëherë</i>	<i>Ndonjëherë</i>	<i>Shpesh</i>	<i>Gjithmonë</i>	<i>Pa përgjigje</i>
Unë kam probleme me prindërit.					
Unë kam probleme me shokët/shoqet.					
Unë i zgjidh konfliktet/sherret/mosmarrëveshjet pa të shara e të bërtitura.					
Unë shqetësohem për ndjenjat dhe nevojat e të tjerëve.					
Unë rri larg gjërave të tilla si alkooli, duhani dhe droga.					
Unë kam pasur probleme me ligjin (policinë, prokurorinë, gjykatën, etj).					
Unë i respektoj rregullat dhe detyrimet e mia.					
Unë kam marrëdhënie të mira në familje.					